Turizmi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I PERSONELIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 4487 Prot. Lezhë më 11.4.2025

URDHËR

Nr. 202 datë 11.04.2025

"PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR HARTIMIN E RREGULLORES SË BASHKISË LEZHË"

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 , nenit 9 pika 1.1 gërma "b", neni 64 gërma "j", të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullores së re të Bashkisë Lezhë, të përbërë nga:
   1. Znj. Eueda Molla — Zv. Kryetare e Bashkisë Lezhë.
   2. Znj. Brikena Vuksani — Zv. Kryetare e Bashkisë Lezhë.
   3. Znj. Jetmira Leka — Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
   4. Z. Altin Lleshi — Drejtor i Drejtorisë Juridike.
   5. Znj. Albana Nikolli — Përgjegjëse Sektori, Sektori i Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
2. Grupi i punës në bashkëpunim me drejtorat e drejtorive të bashkisë dhe administratorët e njësive administrative të hartojnë rregulloren e Bashkisë Lezhë duke propozuar një rregullore të re duke u bazuar në nevojat që ka administrata e Bashkisë Lezhë, në mbarëvajtjen e punës.
3. Drejtuesit e Drejtorive dhe Njësive Administrative të dorëzojnë pranë Sektorit të Protokoll-Arkivit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, përshkrimin, kompetencat dhe detyrat e Drejtorive dhe Njësive Administrative të Bashkisë Lezhë, deri me datë 30.06.2025.
4. Në përfundim të punës së tyre, grupi i punës të paraqesë për miratim projekt-rregulloren e re të Bashkisë e cila duhet të miratohet nga Kryetari i Bashkisë.
5. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen anëtarët e grupit të punës.
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Pjerin Ndreu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LEZHË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SEKRETARIA BASHKIA LEZHË